



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. — prot.

Tiranë, 02.05.2019

**Lënda:** Parashtrimet përfundimtare të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 02.05.2019 pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, lidhur me vendimin nr.22, datë 07.06.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Edmond Islamaj.

**Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Të nderuar gjyqtarë të trupit gjykues,

Bazuar në shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik, prej seancës së parë të gjykimit të kësaj çështjeje më datë 12 nëntor 2018, pasuan edhe 11 seanca të tjera gjyqësore, në të cilat u dëgjuan dhe vlerësuan kërkesat dhe prapësimet e palëve, u kërkuan, paraqitën, administruan fakte dhe prova nga Kolegji, në respektim të kërkesave dhe parimeve për garantimin e procesit të rregullt ligjor.

Megjithëse, në këndvështrimin tonë, nga Komisioneri Publik u argumentua nevoja, kjo trupë gjykuese, në zbatim të nenit F, paragrafi 3 i aneksit të Kushtetutës dhe nenit 45 e vijues të ligjit nr. 84/2016, në funksion të juridiksionit rivlerësues (*ex officio*) vendosi çeljen e hetimit gjyqësor vetëm për disa nga kërkesat dhe shkaqet e ankimit.

Në seancën e datës 17.04.2019 kjo trupë vendosi mbylljen e shqyrtimit gjyqësor, duke administruar të gjitha aktet e ardhura nga Komisioni në fashikullin përkatës dhe të gjithë provat e tjera të marra nga Kolegji gjatë gjykimit të kësaj çështjeje.

Komisioneri Publik, nënvizon se u qëndron të gjitha shkaqeve të parashtruara prej tij në ankim dhe kërkon nga kjo trupë, që në vendimin gjyqësor përfundimtar të shprehet për bazueshmërinë e tyre.

Ndërkohë, duke sjellë në vëmendje se Komisioneri Publik edhe përgjatë seanceve gjyqësore ka parashtruar qëndrimin e tij për fakte dhe prova të administruara, parashtrorjme konkluzionet përfundimtare.

**I. NË LIDHJE ME PASURINË E LLOJIT “KULLOTË” ME SIP. 1.000 m<sup>2</sup>,  
NDODHUR NË \*\*\* /KAVAJË, BLERË NË VITIN 2015 NGA SUBJEKTI I  
RIVLERËSIMIT PËR ÇMIMIN (TOTAL) 137.000 LEKË.**

1. Në kuadër të shkaqeve të ankimit për këtë pasuri, **Komisioneri Publik kërkoi nga trupa gjyquese** hetimin e dy elementeve: (i) historikun e transferimit të pronësisë nga “shtet” në “privat” deri në momentin kur është kaluar titulli i pronësisë te subjekti i rivlerësimit dhe (ii) verifikimin e çmimit minimal dhe maksimal të shit-blerjes për pronat në parcelën nr.\*\*\*, ZK \*\*\* , bazuar në titujt e pronësisë së regjistruar në regjistrat hipotekor.
2. Hetimi gjyqësor nga ana e Kolegjit u krye vetëm për një nga elementet e mësipërme, duke mos u hetuar në lidhje me (ii) verifikimin e çmimit minimal dhe maksimal të shit-berjes për pronat kufitare me pasurinë në pronësi të subjektit të rivlerësimit.
3. Në këtë rast, siç rezultoi e provuar nga aktet e administruara, kjo pasuri prej kalimit të pronësisë nga “shtet” në “privat” në vitin 2009 e deri në vitin 2015 ku subjekti i rivlerësimit e bleu, ka qenë objekt shit-bleje tri herë dhe çmimi i shitjes ka qenë i pandryshuar në vlerën prej 137 lekë për m<sup>2</sup>. Pavarësisht faktit se kjo pasuri ndodhet brenda vijave të zonave të shpallura me potencial të zhvillimit strategjik dhe të turizmit, tre herë shitësi i radhës ka shitur për të njëjtin çmim sa e ka blerë, duke munguar elementi fitim në këto kontrata.
4. Përballë këtij fakti, çmimit tepër të ulët për zonën ku ndodhet kjo pasuri, bazuar dhe në përmbajtjen e akteve të përcjella nga ZVRPP-ja Kavajë, Komisioneri Publik vlerësoi nevojën e hetimit të metejshëm në lidhje me fiktivitetin e çmimit të përcaktuar në kontratën e kalimit të pronësisë në emër të subjektit të rivlerësimit dhe hetimin e çdo konflikti interesi të mundshëm apo trajtimi preferencial të fshehur. Por, Kolegji, u mjaftua me pohimin gjyqësor të subjektit të rivlerësimit për të provuar se ai nuk ka pasur asnjë konflikt interesi apo trajtim preferencial të fshehur në përfitimin e kësaj pasurie. Komisioneri Publik çmon se deklarimi i subjektit të rivlerësimit për këtë pasuri duhet trajtuar sipas parashikimit të nenit 61/5 të ligjit nr.84/2016.

**II. NË LIDHJE ME TRI PASURITË E PALUAJTSHME TË REGJISTRUARA NË  
PRONËSI TË PERSONIT TË LIDHUR/BASHKËJETUESES, ZNJ. \*\*\*.\*\*\***

5. Këto pasuri janë, **apartamenti** me sip.141.13 m<sup>2</sup>, **Njësia/ambient** tregtar me sip.55 m<sup>2</sup> dhe **Garazhi** me sip 16 m<sup>2</sup>, dhe kanë kaluar në pronësi të bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\* rep. dhe nr. \*\*\* kol., datë \*\*\*.11.2001, lidhur ndërmjet znj.\*\*\* në cilësinë e blerëses dhe shitësit, të atit të saj, z. \*\*\* për çmimin total 1.000.000 lekë.
6. **Për këto pasuri, Komisioneri Publik konstatoi se:**
  - 6.1 Nga aktet e dosjes së ILDKPKI-së datë \*\*\*.11.2017 (gjithsej 453 faqe), na rezulton se znj. \*\*\* ka deklaruar si vijon:
    - Në deklarin e parë të interesave private pasurore në vitin 2005 dhe në fq. 8 të Formularit, seksioni mbi të dhënat e interesave private të palujatshme dhe/ose të luajtshme, regjistruar ose jo në regjistrat publikë, nënshkruar rregullisht nga subjekti, nuk ka plotësuar/deklaruar asnjë pasuri të palujatshme për bashkëjetuesen e tij.
    - Në deklarin e vitit 2006 në fq. 8 të formularit, znj. \*\*\* deklaron kontratë qiraje 1 vjeçare për ambjentin njësi me sip. 55 m<sup>2</sup>, në shumën 25.000 lekë. Pra deklaron të ardhura nga kjo pasuri, por pa e deklaruar asnjëherë më parë atë.
    - Në vazhdim nga viti 2007-2009, znj. \*\*\* ka deklaruar që nuk ka ndryshime në pasurinë e palujatshme.
    - Në vitin 2010 deklaron të ardhura në vlerën 3.000 euro nga shitja e makinës “Opel” dhe kursime nga qira dhe paga (fq. 10 e formularit).



- Në vazhdim nga viti 2011, 2012 2013, 2014 znj. \*\*\*\* ka deklaruar gjithashtu që nuk ka ndryshime në pasurinë e paluajtshme.
- Në vitin 2015 znj. \*\*\*\* ka deklaruar blerjen e automjetit “Hyundai” në shumën 3.000 Euro.
- Në vitin 2016 znj. \*\*\*\* ka deklaruar depozitë kursimi në shumën 15.000 euro pranë “ \*\*\*\* Bank”.

6.2 Siç rezulton, tri pasuritë e mësipërme nuk janë deklaruar asnjëherë në deklaratat periodike nga subjekti, edhe pse kishte detyrimin ligjor sipas ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, për deklarimin e tyre dhe burimin e krijimit.

6.3 **Ky fakt rezulton edhe në deklaratën vetting, ku këto pasuri deklarohen për herë të parë, por nuk deklarohet burimi i krijimit të tyre, në kundërshtim kjo me nenin D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.**

#### 7. Në kuadër të shkaqeve të ankimit për këtë pasuri, kërkua nga Kolegji:

- (i) Hetimin e mundësisë financiare të bashkëjetueses \*\*\*\* për të blerë pasuritë, nisur nga të ardhurat e ligjshme që ajo kishte realizuar deri në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes.
- (ii) Hetimin e dokumentacionit hipotekor nga ZVRPP Durrës në lidhje me kohën e regjistrimit të pasurive të mësipërme në regjistrat hipotekor të ZVRPP Durrës, me qëllim konstatimin e pagesës eventuale të penaliteteve në rast regjistrimi të vonuar të këtyre pasurive nisur nga kontradiktat e pasqyruara në shënimet hipotekore të akteve të përcjella nga ZVRPP Durrës gjatë hetimit të kryer nga Komisioni.
- (iii) Evidentimin se deklarimi për herë të parë i këtyre pasurive është bërë në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting”, janar 2017, pavarësisht se pronësia mbi to ishte fituar në vitin 2001 dhe znj. \*\*\*\* kishte deklaruar pranë ILDKPKI-së, prej vitit 2005.
- (iv) Administrimin e praktikës së plotë të lidhjes së kontratave me furnizim me energji elektrike nga OSHEE në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për pasuritë e paluajtshme që gjenden në pallatin me adresë Rr. “ \*\*\*\* ”.

#### 8. Subjekti i rivlerësimit në parashtrimin e tij të datës 12.11.2018 pretendoi se:

*“... bashkëjetuesja i ka deklaruar këto pasuri që në vitin 2006 kur ka deklaruar për herë të parë sipas ligjit 9049 datë 10.04.2003, i ndryshuar. Subjekti pretendon që pranë ILDKPKI-së janë aktet, dosjet të depozituara fizikisht, çka në materialin e ofruar këtu nuk rezulton të jetë e tillë”.<sup>1</sup>*

*“...në ankim vihet në diskutim ligjshmëria e të ardhurave nga paga e bashkëjetueses sime mbi shkakun e pagimit ose jo të detyrimit tatimor. Në vlerësimin tim, pagimi ose jo i detyrimeve tatimore, që në fakt është vetëm tatimi mbi të ardhurat personale, përveç se ka qenë një detyrim ligjor i punëdhënësit nuk mund të bëjë të paligjshëm të ardhurat nga paga përsa kohë ato, sipas Kushtetutës, janë fituar nga një punë e ligjshme, pra mbi një shkak të ligjshëm.”<sup>2</sup>*

*“... ndryshe nga sa Komisioneri Publik hamendëson për vonesa në regjistrimin e titujve të pronësisë së këtyre tre pasurive të paluajtshme dhe, mbi këtë bazë, për pagim penalitetesh sipas ligjit që rregullon sistemin e ri të regjistrimit, në rastin konkret nuk ka pasur asnjë vonesë në regjistrimin e titujve të pronësisë ... dhe as penalitete për vonesë të regjistrimit të tyre në regjistrat e pasurive të paluajtshme”.<sup>3</sup>*

<sup>1</sup> Shih paragrafi 2.2 fq. 4 e parashtrësës së subjektit, datë 12.11.2018.

<sup>2</sup> Shih paragrafi 2.6.3 fq. 7 e parashtrësës së subjektit, datë 12.11.2018.

<sup>3</sup> Shih paragrafi 2.3.5 fq. 6 e parashtrësës së subjektit, datë 12.11.2018.

9. Në vijim të hetimit gjyqësor, Kolegji, (i) me shkresën nr. \*\*\* akti datë \*\*\*.11.2018, kërkoi informacion pranë ZVRPP-së Durrës në lidhje me a) më kohën e regjistrimit të kalimit të pronësisë së tre pasurive në titull të znj.\*\*\*; b) penalitetet eventuale të paguara për vonesë në regjistrim dhe vlerën e tyre; c) vlerën e paguar për rivlerësimin e tre pasurive. Në përgjigje të kërkesës së Kolegjit, ZVRPP Durrës, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.11.2018, informon se regjistrimi i kontratës datë \*\*\*.11.2001 është bërë brenda afatit 30 ditor, pa e shoqëruar këtë përgjigje me asnjë kopje të kartelës së pasurisë së paluajtshme për tre pasuritë. Bashkëlidhur kësaj shkrese, ZVRPP Durrës ka përcjellë dhe aktet e praktikës së rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme datë \*\*\*.02.2012 dhe pagesat bankare të tatimit pas rivlerësimit të tre pasurive të paluajtshme.
10. Lidhur me pretendimin e subjektit se pasuritë e sipërcituara janë deklaruar dhe se aktet ndodhen pranë ILDKPKI-së, Kolegji (ii) me shkresën nr. \*\*\* akti datë \*\*\*.11.2018, kërkoi pranë ILDKPKI-së të dhënat në lidhje me deklaratimet e subjektit. Në përgjigje të kërkesës së Kolegjit, ILDKPKI-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.11.2018 ka përcjellë një sërë aktesh, pjesë e të cilave janë dhe dy fletë deklarate e interesave private periodike vjetor të vitit 2005 të znj.\*\*\*. Në këto dy faqe të kësaj deklarate, që nga shënimet e saj duhet të jetë dorëzuar në datë \*\*\*.03.2006, ndër të tjera, znj.\*\*\* ka deklaruar dhe pronësinë mbi tre pasuritë e paluajtshme, apartament, dyqan dhe garazh.
11. Në përfundim të gjykimit për këto tre pasuri, duke konsideruar dokumentacionin e dorëzuar nga ana e subjektit të rivlerësimit, prapësimet e tij, aktet e përcjella nga ZVRPP-ja Durrës, ILDKPKI-ja, **Komisioneri Publik vlerëson se:**
- 11.1 Në inventarin e akteve të dosjes të ILDKPKI-së (pjesë e dosjes së Komisionit) nuk rezultojnë të administruara dy fletët e deklaratimit vjetor të vitit 2005 (dorëzuar më datë \*\*\*.03.2006), të cilat për herë të parë janë përcjellë nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\* 11.2018, në përgjigje të kërkesës së Kolegjit.
- 11.2 Lidhur me burimin e ligjshëm për krijimin e pasurive të bashkëjetueses, subjekti nuk arriti të provojë se të ardhurat e bashkëjetueses së tij plotësojnë kërkesat kushtetuese e ligjore për t'u konsideruar si të ligjshme.
- 11.3 Për vlerësimin e burimit të ligjshëm, aktet e administruara në dosje janë: (i) vërtetim datë \*\*\*.01.2017 nga OJF "\*\*\*\*", ku për periudhën tetor 1999-korrik 2000, pretendohet se znj.\*\*\* ka përfituar pagesë 500 USD në muaj; (ii) shkresë nga organizata joftimprurëse \*\*\* datë \*\*\*.09.1999 që referon që znj.\*\*\* ka punuar 3 muaj pranë kësaj organizate; (iii) vendim për regjistrim si person juridik të Gjykatës së rrethit gjyqësor Durrës nr. \*\*\* datë \*\*\*.02.2001 me objekt veprimtarie "Përkthim dhe tregëti të artikujve kancelarie".
- 11.4 Në faqen 6 të parashtrësës së tij, depozituar në Kolegj datë \*\*\* 11.2018, subjekti vetë pranon "*...që për dy punët e fundit që rendita nuk mund t'i provojmë me dokumente provuese të përkthyer në shifra, se sa kanë qenë të ardhurat e realizuara prej saj, pavarësisht hapësirës ligjore dhe parashikimit konkret shumë të rëndësishëm që ka bërë ligjvënësi në Kushtetutë dhe në nenin D të aneksit të saj*".
- 11.5 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, në zbatim të përcaktimit kushtetues, vetëm nëpërmjet një burimi të ligjshëm mund të krijohet një pasuri e ligjshme, e tillë që të materializohet në formën e të ardhurave të deklaruara dhe për të cilat të jenë paguar detyrimet tatimore. Ekzistenca e burimit të ligjshëm, marrëdhënia e punësimit, në rastin konkret mbetet në nivel deklarativ, bazuar në një shkresë të nënshkruar dhe vulosur nga një subjekt OJF, që nuk rezulton të jetë provuar as statusi ligjor aktual.



11.6 Nderkohë në zbatim të përcaktimit kushtetues, pasuri të ligjshme, konsiderohen vetëm ato të materializuara në të ardhura që janë deklaruar (saktësisht dhe mjaftueshmërisht) dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Sa më sipër, referuar provave, dokumenteve dhe pretendimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, vlerësojmë se i vetmi dokument që provon të ardhura nga marrëdhënia e punës është vërtetimi i OJF-së “ \*\*\*\* ” për periudhën tetor 1999- korrik 2000, ku znj. \*\*\*\* ka përfituar pagesë 500 USD/muaj. Nga kjo marrëdhënie e pretenduar punësimi, të ardhurat totale për znj. \*\*\*\* janë në shumën 730.386,84 lekë. Këto të ardhura nuk mund të konsiderohen si të ligjshme, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3 pika 19 e ligjit nr. 84/2016, përse kohë që nuk rezultoi e provuar që janë paguar detyrimet tatimore për to. Ky interpretim gjen pasqyrim dhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

11.7 Përfundimisht për të tre pasuritë e bashkëjetueses \*\*\*\* na rezulton se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016 dhe nuk ka vërtetuar burimin e ligjshëm të krijimit të tyre.

### III. NË LIDHJE ME PASURINË E PALUAJTSHME NDËRTESË+TRUALL NË PRONËSI TË FËMIJËVE TË MITUR, DHURUAR NGA PRINDËRIT E SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT. SIP. TOTALE 106.7 m<sup>2</sup>

12. Kjo pasuri është e regjistruar pranë ZVRPP-së Durrës me nr. \*\*\*\*, ZK nr. \*\*\*\*, ndodhur në \*\*\*\*, Durrës. Pronësia e dy fëmijëve të mitur të subjektit të rivlerësimit mbi këtë pasuri e ka origjinën nga kontrata e dhurimit, nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol., datë \*\*\*\*.05.2017, nëpërmjet të cilës prindërit e subjektit të rivlerësimit z. \*\*\*\* dhe znj. \*\*\*\* ua dhurojnë nipërve të tyre. Në cilësinë e pranuesve të dhurimit janë subjekti i rivlerësimit dhe bashkëjetuesja znj. \*\*\*\*, si prindër të fëmijëve të mitur.

13. Komisioneri Publik, në kuadër të hetimit të kësaj pasurie kërkoi nga Kolegji:

- (i) Hetimin e marrëdhënies eventuale të huasë mes babait të subjektit të rivlerësimit dhe babait të bashkëjetueses së tij.
- (ii) Hetimin e mundësisë së ekzistencës së të ardhurave të ligjshme në emër të babait të subjektit të rivlerësimit, që kanë shërbyer si burim i ligjshëm për blerjen e pasurisë së paluajtshme duke qenë se:

Në vështrim të nenit 32/4 dhe 52, të ligjit nr. 84/2016, duhet të verifikohet burimi i pasurisë së dhuruar dy fëmijëve të mitur të subjektit të rivlerësimit, nisur edhe nga fakti që dy prindërit e subjektit, në momentin e blerjes së pronës, rezultojnë të dy të jenë me statusin e pensionistëve dhe pa të ardhura të tjera, përveç përfitimeve nga skema e sigurimeve shoqërore. Megjithatë z. \*\*\*\*, babai i ndjerë i subjektit të rivlerësimit, në momentin e kryerjes së këtij procesi rivlerësimi ka ndërruar jetë, palë e kontratës së dhurimit për dy fëmijët e mitur është nëna e subjektit të rivlerësimit, e cila në kuptim të dispozitave të Kodit të Familjes dhe Kodit Civil gëzonte të drejtën e bashkëpronësisë mbi sendin. Nisur dhe nga fakti se në emër të prindërve të subjektit të rivlerësimit rezultojnë depozita bankare në shuma të konsiderueshme, me qëllim hetimin e burimit të ligjshëm edhe për fitimin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme në fjalë, Komisioni duhet të kishte marrë deklaratimet e saj.

- (iii) Hetimi dhe marrja e informacioneve nga ana e noterit z. \*\*\*\*<sup>4</sup> duke qenë se të dhënat e përfituara nga dokumentacioni shkresor bankar i vitit 2014, vërtetojnë derdhjen e shumë prej 3.000.000 lekë nga z. \*\*\*\*, në llogari të noterit z. \*\*\*\*, për llogari të transaksionit financiar të shitjes së pasurisë së paluajtshme konform parashikimit kontraktor.

<sup>4</sup> Në kuptim të nenit 51, të ligjit nr. 84/2016.

**14. Në parashtrimin e datës 12.11.2018 pranë Kolegjit, subjekti i rivlerësimit pretendoi se:**

*“...pas dakordësimit të shitjes dhe çmimit të saj, ende pa u formalizuar ajo, në kushtet e një marrëdhënieje miqësore mes tyre, prindërit e mi u kanë paguar në dorë, cash, çmimin e shitjes në favor të bashkëpronarëve të pronës. Ndërsa kanë vendosur të formalizojnë veprimin juridik të shitjes, në kushtet kur rregullat për kalimin e pronësisë së pasurive të paluajtshme kishin ndryshuar, tashmë çmimi i shitjes duhet të paguhej në llogari bankare përmes noterit, mbasi një gjë të tillë jua ka bërë prezent noteri në rastin e paraqitjes përpara tij dhe lidhjes së kontratës së shitblerjes nr. \*\*\* rep \*\*\* kol datë \*\*\* .10.2014. Nisur nga kjo rrethanë, babai i bashkëjetueses sime i ka kthyer babait tim çmimin e paguar nga ai me para në dorë, më përpara se të kryenin veprimet noteriale. Këtë veprim punonjësi i Bankës, duke mos e ditur atë marrëdhënie juridike mes babait të bashkëjetueses sime dhe babait tim, në neglizhencë dhe në mënyrë të gabuar e ka cilësuar si “hua”...”<sup>5</sup>.*

*“... babai im i ndjeri \*\*\* ka patur licensë dhe ka ushtruar profesionin e avokatit nga prilli i vitit 1993. Njëkohësisht ai ka patur licensën nr. \*\*\* dhe ka ushtruar gjatë kësaj periudhe edhe profesionin e ekspertit kriminalist. Për këto aktivitete ai ka qenë i regjistruar rregullisht edhe në organet tatimore deri kur i ka mbyllur ato ndërsa është licensuar si noter, funksion dhe veprimtari të cilën e ka ushtruar derisa doli në pension pleqërie. Si rezultat i këtyre veprimtarive private, babai im ka krijuar të ardhura... Dhe përveç të ardhurave në llogaritë bankare, në funksion të pagimit të çmimit të blerjes, babai im ka patur edhe të ardhurat e fituar nga shitja, në Korrik të vitit 2014, të automjetit “Land Rover”<sup>6</sup>.*

**15. Kolegji, në funksion të hetimit dhe shqyrtimi gjyqësor, me shkresën nr. \*\*\* akti, datë \*\*\* .11.2018 kërkoi pranë Drejtorisë Rajonale Durrës të dhënat tatimore lidhur me të ardhurat e krijuara gjatë ushtrimit nga babai i subjektit të rivlerësimit të aktiviteteve si profesionist i lirë (noter, avokat, ekspert kriminalist) nga prilli 1993. Në përgjigje të kërkesës së Kolegjit, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\* .11.2018 ka dërguar një tabelë me të ardhurat (xhiro) të deklaruara nga subjekti tatimor \*\*\* nga viti 2000 deri në vitin 2005, duke pasqyruar në tabelën dhe vlerën e tatimit të paguar çdo vit.**

**16. Në përfundim të gjykimit për këtë pasuri, në konsideratë të dokumentacionit të dorëzuar nga ana e subjektit të rivlerësimit, prapësimet e tij, përgjigjen e Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, Komisioni Publik vlerëson se:**

16.1 Në lidhje me mënyrën e pagesës së çmimit për këtë pasuri, deklaramet e administruara nga ana e Komisionit prej babait të bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit, z. \*\*\*\*, subjektit të rivlerësimit dhe parashtrimet e tij pranë Kolegjit në seancën e datës 12.11.2018 janë kontradiktore.

16.2 Fillimisht përpara Komisionit, subjekti nuk ka përjashtuar mundësinë e ekzistencës së një marrëdhënie huaje, konkretisht në parashtrime të rezultatit të hetimit datë 28.05.2018, administruar në dosje ka deklaruar: *“... theksoj se me sa jam në dijeni, babai im për blerjen e banesës dhe truallit, që ia ka dhuruar më pas fëmijëve të mi, ai ka pasur para të tijat për të kryer blerjen e ndërtesës një katëshe dhe truallit të saj. Megjithatë duke qenë se im atë nuk jeton më, unë nuk mund të përjashtoj mundësinë e një marrëdhënie huaje, ku përfitues kanë qenë fëmijët e mi dhe mua të më kenë mbajtur jashtë kësaj marrëdhënie të tyre.*

16.3 Në parashtrimet e tij para Kolegjit jep shpjegime të detajuara në lidhje me pagesën e vlerës Cash nga ana e babait të tij të ndjerë në vlerën 3.000.000 lekë. Por ky deklaram është

<sup>5</sup> Shih paragrafi 4.9 dhe 4.10 faqja 13-14 e parashtrësës së subjektit datë 12.11.2018.

<sup>6</sup> Shih paragrafi 4.14 faqja 14-15 e parashtrësës së subjektit datë 12.11.2018.

kontradiktor me deklarinimin e z. \*\*\*\* përpara Komisionit, ku shprehet se babai i subjektit të rivlerësimit nuk i ka dhënë para *Cash* në dorë, por gjithcka është kryer nëpërmjet llogarive bankare (deklarim datë \*\*.04.2018).

- 16.4 Në lidhje me të ardhurat e ligjshme në emër të babait të subjektit të rivlerësimit, që kanë shërbyer si burim për blerjen e pasurisë së paluajtshme, Kolegji u mjaftua në hetimin e tij me përgjigjen e Drejtorisë Rajonale Tatimeve Durrës, nr. \*\* prot., datë \*\*.11.2018. Nga të dhënat e pasqyruara në përmbajtjen e saj, nuk mund të evidentohet niveli i fitimit real, si diferencë e të ardhurave me shpenzimet, fakt ky që nuk mundëson llogaritjen e aftësisë financiare të babait të subjektit me burime të ligjshme. Subjekti ka deklaruar si një nga zërat për krijimin e kësaj pasurie edhe të ardhurat e fituar nga shitja e automjetit “Land Rover”, në Korrik të vitit 2014, analizën e së cilës e do ta paraqesim në vijim.

#### IV. NË LIDHJE ME AUTOMJETIN “OPEL CORSA” DHE “MERCEDES BENZ”

17. Referuar DV së vitit 2010, personi i lidhur/bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar shitjen e një automjeti tip “Opel Corsa” për vlerën 3.000 euro. Ky automjet nuk rezulton të jetë deklaruar më parë në pronësi (referoju prg.6.1). Gjithashtu në DV e vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shitjen e një automjeti të tipit “Mercedez Benz” për vlerën 4.000 euro, automjet ky i deklaruar në DV 2004 në pronësi të subjektit të rivlerësimit.
18. Duke qenë se për shitjen e këtyre automjeteve gjatë hetimit administrativ të Komisionit, ky i fundit nuk kishte administruar kontratat e shit-blerjes për qëllim të nenit D të aneksit të Kushtetutës, element i nevojshëm për analizën financiare (ligjshmëria e vlerës 7.000 euro), nga ana e Komisionerit Publik u adresua si shkak ankimi dhe pamjaftueshmëri hetimi.
19. **Subjekti i rivlerësimit** në parashtrimet e tij të datës 12.11.2018, pretendoi se: “... *deklarimi i bashkëshortes sime është bërë që në vitin e parë të saj për të gjitha pasuritë, por kjo nuk është përcjellë nga ILDKPKI-ja... Kontrata e blerjes dhe ajo e shitjes së kësaj pasurie janë depozituar në deklarinimin vjetor përkatës të pasurive, blerja në deklarinimin që i referohet vitit 2004, shitja në deklarinimin që i referohet vitit 2010, si dhe deklaratën vetting të pasurisë të vitit 2017...*”
20. Si rezultat i hetimit të ndërmarrë nga ana e Kolegjit lidhur me këtë pretendim të subjektit, ILDKPKI-ja me shkresën nr. \*\* prot., datë \*\*.11.2018 përcolli një sërë aktesh, ku pjesë e tyre janë edhe dy fletë deklaratë e interesave privatë për vitin 2005 e znj. \*\*\*\*, dhe kontratat e shit-blerjeve të automjeteve të sipërcituara.
21. **Sa më sipër, vlerësojmë se:**
- 21.1 Inventari i akteve të dosjes së ILDKPKI-së datë \*\*.11.2017, në fashikullin e Komisionit është me 473 fletë gjithsej të administruara, dhe në të nuk rezultojnë dy fletët e deklarinimit vjetor të vitit 2005 (dorëzuar më datë \*\*.03.2006) si dhe kontratat e shit-blerjeve të përcjella nga ILDKPKI-ja gjatë hetimit gjyqësor në përgjigje të kërkesës së Kolegjit.
- 21.2 Rezultojnë mospërputhje dhe kontradikta midis deklarinimit të subjektit dhe fakteve të administruara, pasi kontratat e shit-blerjes së këtyre automjeteve nuk janë dorëzuar në vitet respektive të deklarinimit, pra vitet 2004 dhe 2010. Kjo rrethanë vërtetohet nga fakti se kopjet e këtyre kontratave, përcjellë nga ILDKPKI-ja më datë \*\*.11.2018, rezultojnë të noterizuara nga noteri publik z. \*\*\*\* më datë \*\*.03.2016. Gjithashtu nga përgjigjia e DPSHTRr-së për Komisionin, lidhur me automjetet në pronësi apo ish-pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, rezulton fakti se automjetet e sipërcituara nuk përmenden të kenë qenë në pronësi të subjektit dhe personit të lidhur me të.

21.3 Në këto kushte, Komisioneri Publik kërkoi investimin e Kolegjit për administrimin si provë të praktikës së plotë pranë DPSHTRr-së, mbi regjistrimin/pronësinë apo ç' regjistrimin e këtyre mjeteve, kërkesë kjo që nuk u pranua nga ana e Kolegjit. Komisioneri Publik, në referencë të nenit 61/3/5 të ligjit nr. 84/2016, i kërkoi kësaj trupe gjyqësore të vlerësojë se nga përmbajtja e kontratave të shit-blerjes, dorëzuar vetëm gjatë shqyrtimit gjyqësor pranë Kolegjit, u konstatua se:

- (i) Për automjetin e llojit "Mercedez Benz", megjithëse rezultonte me status "i ç' regjistruar" nga qarkullimi civil, sipas vërtetimit të DPSHTRr-së i datës \*\*\*.04.2010, subjekti pas 7 vitesh përdorim dhe pasi e kishte blerë për vlerën 500.000 lekë, ia shet me kontratë shkresore të thjeshtë për pjesë këmbimi, blerësit \*\*\*\* për shumën 546.120 lekë (4 mijë euro), duke realizuar kështu edhe fitim.
- (ii) Për automjetin e llojit "Opel Corsa", vit prodhimi 1996, blerë në vitin 2004 nga bashkëjetuesja e subjektit për 200.000 lekë dhe shitur në 2010 në shumën 3.000 euro me kontratën noteriale të datës \*\*\*.1.2010. Edhe në këtë rast, në të kundërt me logjikën normale të tregut, normat e amortizimit, realizohet fitim në shitje të një automjeti pas 6 vitesh përdorimi nga ana e bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit.

21.4 Për të dyja këto transaksione, veç faktit se ato pasqyrojnë elementë të fiktivitetit (për dukje) lidhur me çmimit, edhe nëse i marrin të mirëqena si vlera të dakordësuara me vullnet nga palët, nga shqyrtimi gjyqësor nuk u provua në asnjë rast pagimi i detyrimeve tatimore mbi fitimin e realizuar nga shitja e tyre. Si rrjedhojë, në analizën financiare të kryer nga ana e Komisionerit Publik, trajtuar në vijim mbi likuiditetet, të ardhurat prej 7.000 euro nga shitja e automjeteve të sipërcituara nuk janë marrë në konsideratë, në referencë kjo të nenit D të aneksit të Kushtetutës.

#### **V. NË LIDHJE ME AUTOMJETIN "LAND ROVER" I VIT PRODHIMIT 2005, BLERË NGA SUBJEKTI NË VITIN 2010**

22. Komisioneri Publik, në kuadër të hetimit të kësaj pasurie kërkoi nga Kolegji:

- (i) Hetim dhe administrimin e dokumentacionit që provon blerjen/pagesën e vlerës prej 21.000 euro ndaj shoqërisë " \*\*\*\* " sh.p.k në vitin 2010.
- (ii) I ati i subjektit të rivlerësimit, si bashkëpronar me 60 % të vlerës së këtij mjeti, për qëllim të ligjit nr. 84/2016 të konsiderohet si person tjetër i lidhur, fakt i cili do të mundësonte kontrollin e aftësisë së tij paguese dhe burimin e ligjshëm të vlerës prej 12.600 euro në vitin 2010 (60% e vlerës së automjetit).
- (iii) Vërtetimin e mënyrës së marrjes së shumës prej 20.000 euro në maj të vitit 2014, si çmim i shitjes së këtij automjeti tek \*\*\*\* (i vëllai i administratorit të shoqërisë " \*\*\*\* ")

23. Subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e tij të datës 12.11.2018 pranë Kolegjit, ndër të tjera, paraqiti si provë:

- (i) Dy mandate të Bankës " \*\*\*\* " sipas të cilave shumat janë paguar nga subjekti i rivlerësimit, (përveç mandatit të Bankës \*\*\* për pagesën e shumës prej 6.000 euro i cili është depozituar nga subjekti edhe gjatë hetimit administrativ);
- (ii) Analizë, veprime klienti nga shoqëria " \*\*\*\* " sh.p.k, me vull të kësaj shoqërie dhe ku janë reflektuar pagesat në shumat 10.000 euro, 5.000 euro dhe 6.000 euro (total 21.000 euro);
- (iii) Leje për ushtrimin e profesionit të avokatit, e datës \*\*\*.04.1993 për të atin e subjektit. Provë kjo e dorëzuar nga subjekti me qëllim faktimin se i ati i tij ka pasur të ardhura financiare për pagimin e 60% të vlerës së mjetit;





- (iv) Urdhër nr. \*\*\*\*, datë \*\*.08.2010 të Ministrit të Drejtësisë, “Për heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit”, për të atin e subjektit. Provë kjo e dorëzuar nga subjekti me qëllim provimin se i ati i tij ka pasur të ardhura financiare për pagimin e 60% të vlerës së mjetit.
- 24. Kolegji në seancën e datës 17.12.2018**, ndër të tjera vendosi t’i japë kohë subjektit të rivlerësimit për të shpjeguar dhe provuar mënyrën e marrjes së shumës 20.000 euro, si çmim të shitjes së automjetit “Land Rover”.
- 25. Në seancën e datës 20.12.2018**, subjekti i rivlerësimit paraqiti një deklaratë noteriale të datës \*\*.12.2018 të deklaruesit \*\*\*\*, mbajtur para noterit publik \*\*\*\*. Në këtë deklaratë, \*\*\*\* deklaron se çmimin prej 20.000 Euro ia ka shlyer palës shitëse \*\* dhe \*\*\*\*, në tre këste *cash*, gjatë periudhës korrik, gusht dhe shtator 2014. Kjo deklaratë duhet të çmohet nga kjo trupë sipas parashikimit të nenit 49/1/c të ligjit nr. 84/2016.
- 26. Sa më sipër, vlerësojmë se:**
- 26.1 Dokumentet e paraqitura nga subjekti nga banka “ \*\*\*\* ”, nuk mund të konsiderohen në cilësinë e provës, pasi në aspektin formal dhe fuqisë provuese të tyre nuk dallohen ekstremitetet e nevojshme si vula datare e bankës, nënshkrimi i punonjësit të saj si dhe nënshkrimi i subjektit.
- 26.2 Deklarata noteriale e datës \*\*.12.2018 e deklaruesit \*\*\*\* nuk mund të merret në konsideratë, pasi ajo nuk është në harmoni dhe përputhje me provat e tjera të administruara, në raport kjo me faktet e rezultuara dhe atyre të pretenduara nga subjekti. Kjo deklaratë është mbajtur dhe vënë në dispozicion gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegji, fakt i cili në raste të ngjashme ka sjellë mos konsiderimin e tyre nga ana e Kolegjit.
- 26.3 Lidhur me blerjen e këtij automjeti, referuar prapësimeve gjatë seancës gjyqësore në Kolegji, konstatojmë se subjekti ka dhënë deklarime të ndryshme lidhur me kryerjen e pagesave. Në parashtrimet e tij subjekti deklaron: “... në lidhje me pagesën e çmimit të shitjes së këtij automjeti, pavarësisht se veprimi juridik i kryer në këtë rast është mes një shoqërie private dhe dy individëve, mua subjektit të rivlerësimit dhe babait tim, duke mos përbërë detyrim ligjor për pagimin e çmimit përmes bankës, në realitet për siguri dhe garanci të dyanshme, pagesa për blerjen e automjetit është bërë nëpërmjet kanalit bankar.”
- 26.4 Ky qendrim është kontradiktor me deklarinimin e tij në parashtrimet ndaj rezultateve të hetimit të Komisionit të datës 28.05.2018, ku deklaron se: “... pagesa e përmendur nga ana juaj është bërë pranë arkës së shoqërisë. Kjo e fundit ka kryer veprimet në bankë sipas zakonit tregtar të ndjekur prej saj.”
- 27. Në lidhje me aftësinë financiare nga burime të ligjshme e babait të subjektit për pagesën e pjesës takuese-60% të vlerës së automjetit, çmojmë se:**
- 27.1 Dokumentacioni i paraqitur nga subjekti në mbrojtje të pretendimit të tij se babai ka ushtruar profesionin e avokatit dhe atë të ekspertit kriminalist dhe prej vitit 1999 atë të noterit, duke dorëzuar akte si, vendim regjistrimi si avokat dhe heqjen e liçencës si noter, **nuk** provojnë pretendimin e subjektit mbi të ardhurat e realizuara, apo aftësinë financiare të të atit për mbulimin e pagesës prej 60% të vlerës së mjetit.
- 27.2 Nga aktet e administruara si rezultat i hetimit të Komisionit dhe Kolegjit lidhur me aktivitetin e babait të subjektit të rivlerësimit, konstatohen mospërputhje midis vetë konfirmimeve të DPT Durrës.

- 27.3 Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\* .01.2018, DRT Durrës lidhur me aktivitetin e shtetasit \*\*\* i konfirmon Komisionit se: "... nga sistemi C@ts subjekti \*\*\* me NIPT rezultoi i ç'rregjistruar që në datë \*\*\* .02.2000."
- 27.4 Ndërkohë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\* .11.2018 dërguar Kolegjit, DRT Durrës, konfirmon faktin se: "... nga verifikimi i të dhënave në sistemin C@ts shtetasi \*\*\* figuron i regjistruar në DRT Durrës... Statusi, i ç'rregjistruar që më datë \*\*\* .01.2005. Për këtë subjekt nuk ka deklarime në sistemin informatik C@ts. Nga verifikimi i të dhënave në dosjen e tatimpaguesit që disponohet në arshivën e DRT Durrës, rezultojnë të deklaruara të ardhura (xhiro) dhe pagesa të kryera sipas viteve (të paraqitura në tabelë)..."
- 27.5 Sipas informacionit të administruar nga Kolegji, rezulton se babai i subjektit të rivlerësimit për periudhën 2000-2004 ka deklaruar xhiro shumë prej 9.486.650 lekë për të cilat rezulton se ka paguar detyrimet tatimore për periudhën 2000-2005 në shumë totale prej 551.106 lekë.
- 27.6 Në vlerësim të Komisionerit Publik, të dhënat e vëna në dispozicion nga DRT Durrës, përveçse janë kontradiktore midis dy përgjigjeve të të njëjtit insitucion, nuk janë të plota. Informacioni i vënë në dispozicion nuk mundëson kryerjen e analizës financiare për babain e subjektit të rivlerësimit, duke marrë në konsideratë këtu faktin se nuk kemi të dhëna mbi shpenzimet e kryera në funksion të aktivitetit për këtë periudhë (shpenzime operative në funksion të aktivitetit si qera, energji, kancelari, etj.) për të mundësuar evidentimin e fitimit real. Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion, nuk është i mundur verifikimi i mundësisë financiare të babait të subjektit të rivlerësimit për investimin e shumës prej 12.600 Euro në vitin 2010 për blerjen e autoveturës. Theksojmë këtu se aktiviteti figuron i ç'rregjistruar në datë \*\*\* .01.2005 dhe ISSH me shkresën nr. prot \*\*\* datë \*\*\* .01.2018 në përgjigje të Komisionit, konfirmon faktin se shtetasi \*\*\* trajtohet me pension pleqërie nga qershori 2007 deri në prill 2017 (në masën 20.835+9.525 lekë), si dhe e ëma e subjektit \*\*\* trajtohet me pension pleqërie që nga maji 2017.
- 27.7 Gjithashtu nga informacioni i vënë në dispozicion rezulton se babai i subjektit të rivlerësimit ka kryer investime në: Depozitë bankare dyemërore, në emër të \*\*\* dhe \*\*\* (prindërit e subjektit) në vlerën 10.350 USD, gjëndje në \*\*\* .12.2003, sipas konfirmimit të \*\*\* Bank (depozitë në të cilën rezulton të jenë kryer derdhje<sup>7</sup> dhe tërheqje përgjatë viteve deri në mbylljen e saj në vitin 2016); Depozita në \*\*\* , sipas së cilës në emër të \*\*\* ekziston depozita gjëndje në mars 2007 në shumë prej 4,031,068 lekë (depozita është maturuar dhe rivendosur disa herë, derisa ka kaluar në vitin 2008 në llogari të bashkëshortes \*\*\* në shumë 1.800.000 lekë).

## VI. NË LIDHJE ME MOS DEKLARIMIN E PËRDORIMIT TË AUTOMJETIT "LAND ROVER DISCOVERY" VIT PRODHIMI 2012

28. Komisioneri Publik, në kuadër të hetimit të kësaj pasurie kërkoi nga Kolegji:
- Marrjen nga DPSHTRr-ja të dosjes së plotë mbi këtë automjet me qëllim përcaktimin e çmimit të këtij aseti kur i ka kaluar shoqërisë " \*\*\* " sh.p.k;
  - Hetimin e raporti ligjor që ka ekzistuar mes shoqërisë dhe subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 49/4 të ligjit nr. 84/2016.
29. Kolegji nuk e vlerësoi të nevojshme hetimin e këtij aseti, mbi shkaqet e ngritura nga ana jonë.

<sup>7</sup> Dërdhur shuma 8.000 USD datë \*\*\* .02.2008; dërdhur shuma 3.000 USD datë \*\*\* .03.2009; dërdhur shuma 2.000 USD datë \*\*\* .11.2014.



30. Në parashtrimin e tij të datës 12.11.2018, subjekti ndër të tjera ka pretenduar: “... Që të kemi të drejtën reale të përdorimit sipas kuptimit civil kërkohet një përdorim i pandërprerë dhe i vazhduar që lidhet me marrëdhënien e drejtpërdrejtë mbi sendin me përdoruesin. Ndërkohë pagimi i policës së siguracionit nuk është një kontratë që do të thotë pasjen e një të drejte reale mbi automjetin. Automjeti në fjalët është marrë në huapërdorje për periudha të shkurtra dhe për qëllime të caktuara. Emri në policën e sigurimit është me qëllim për të patur garancitë e nevojshme në rast dëmi dhe për sa i përket kartonit jeshil, në rastet për udhëtimet jashtë”.

**31. Sa më sipër, vlerësojmë se:**

31.1 Pretendimet e subjekti nuk shpjegojnë faktin se pse për automjetin e mësipërm janë prerë dy polica sigurimi një vjeçare (TPL), përkatësisht për periudhat 22.09.2014-21.09.2015 dhe 15.10.2015-14.10.2016, në cilësinë e përdoruesit të mjetit.

31.2 Këto polica provojnë se përdorimi i këtij mjeti nuk ka qenë i shkëputur dhe me raste të caktuara, por i vazhdueshëm në kohë.

31.3 Provohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar përdorimin e këtij automjeti në përputhje me detyrimin e parashikuar nga ligji nr. 84/2016 për plotësimin e shtojcës 2.

**VII. NË LIDHJE ME LIKUIDITETET NË FORMËN E DEPOZITAVE BANKARE DHE CASH TË SUBJEKTIT DHE PERSONIT TË LIDHUR ME TË**

32. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratat e interesave privatë vjetore të depozituara pranë ILDKPKI-së për periudhën 2003-2015 kursime në *cash* të cilat në total arrijnë vlerën e **10.493.870** lekë.

33. Në datë <sup>\*\*\*</sup>.04.2016 subjekti dhe bashkëjetuesja e tij kanë depozituar kursimet prej rreth **4.884.350<sup>8</sup>** lekë, respektivisht pranë “<sup>\*\*\*</sup>” Bank dhe “<sup>\*\*\*</sup>” Bank.

34. Nga analiza deklaratave të interesave privatë vjetore, të përdorura si provë bazuar në nenin 32 pika 5 të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar se subjekti dhe personi i lidhur me të, nuk mbulojnë me të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara në datë 31 dhjetor të çdo viti deklarues.

35. Ky fakt nuk rezulton të jetë hetuar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, shkak për të cilin Komisioneri Publik kërkoi kryerjen e hetimit të mëtejshëm nga ana e Kolegjit.

36. Kolegji ka kryer analizën ekonomiko financiare për subjektin e rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, për periudhën 2004-2016 me qëllim verifikimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të për të justifikuar me të ardhura të ligjshme shpenzimet e kryera dhe pasuritë e krijuara ndër vite.

37. Kolegji ka analizuar deklaratat vjetore të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit pranë ILDKPKI-së vit pas viti. Nga analiza vjetore e të ardhurave, shpenzimeve dhe kursimeve në *cash* të deklaruara nga subjekti si dhe nga informacioni i vënë në dispozicion nga bankat e nivelit të dytë, për periudhën 2004-2016, Kolegjit i ka rezultuar se subjekti nuk mbulon me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e deklaruara për një total prej **-5,382,687.81** lekë.

38. Referuar analizës financiare të përgatitur nga Kolegji, **Komisioneri Publik** mban qendrimin se:

**a. Fillimisht mbi të ardhurat e ligjshme.**

<sup>8</sup> Kundërvlera në lekë me kursin e Bankës së Shqipërisë, 1 euro = 138.41 lekë datë <sup>\*\*\*</sup>.04.2016 e dy depozitave respektivisht 20.000 euro në emër të SR dhe 15.000 euro në emër të Bsh.

- 38.1 Rezulton se në analizën e kryer nga Kolegji, në burimet e ligjshme të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, janë marrë në konsideratë (i) të ardhurat nga paga dhe shpërblimet e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëjetueses së tij; (ii) të ardhurat nga qiradhënia e pasurive të bashkëjetueses së tij; (iii) të ardhurat nga shitja e dy automjeteve në vitin 2010, të tipit “Mercedez Benz” dhe “Opel Corsa”, si dhe (iv) të ardhurat nga shitja e automjetit e tipit “Land Rover”, në vitin 2014.
- 38.2 Lidhur me konsiderimin si burimi i ligjshëm nga ana e Kolegjit i të ardhurave nga shitja e automjeteve në vitin 2010, nga analiza e akteve në dosje, ka rezultuar se të dy autoveturat e sipërcituara janë shitur me çmim më të lartë se çmimi i blerjes, duke realizuar kështu fitim. Kontratat e shitjes së këtyre dy mjeteve janë vënë në dispozicion nga ILDKPKI-ja vetëm pas kërkesës së Kolegjit me shkresën nr. \*\*\* datë \*\*\* .11.2018 dhe nuk kanë rezultuar të kenë qënë pjesë e dosjes së inventarizuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja në datë \*\*\* .11.2017.
- 38.3 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, mbështetur dhe në nenin D pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, shuma prej 964.502 lekë (kundërvlera në lekë e çmimeve të shitjes së automjeteve, 4.000 euro + 3.000 euro) nuk mund të konsiderohet si e ardhur e ligjshme e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, pasi nuk rezulton të jetë paguar tatimi mbi të ardhurat e realizuara nga diferenca e çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes<sup>9</sup>. Rrjedhimisht të ardhurat e ligjshme për vitin 2010 përbëhen vetëm nga pagat e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëjetueses së tij si dhe të ardhurat nga qiraja e pasurive të kësaj të fundit.
- 38.4 Lidhur me të ardhurat e realizuara nga shitja e automjetit “Land Rover” në vitin 2014, rezulton se në analizën financiare për vitin 2014, Kolegji ka konsideruar si të ardhura të ligjshme të subjektit edhe të ardhurat nga shitja e këtij automjeti në shumën 1.119.790 lekë (për pjesën takuese të deklaruar nga subjekti në masën 40%).
- 38.5 Përveçse, siç ka rezultuar nga dokumentacioni i këtij automjeti dorëzuar nga DPTRr, mbi rishitjen e tij vetëm dy ditë më pas nga blerësi për 15.000 euro, duke rezultuar në 5.000 euro humbje për shitësin, theksojmë se kjo shumë e konsideruar si e ardhur e ligjshme nga ana e Kolegjit, është mbështetur në deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., e datës \*\*\* .12.2018, sikundër arsyetuar më sipër në pikën 26.2.
- 38.6 Në këtë logjikë, në vlerësimin e Komisionerit Publik, të ardhurat e ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëjetueses së tij për vitin 2014, përbëhen vetëm nga të ardhurat nga pagat e subjektit dhe bashkëjetueses së tij si dhe nga interesat bankare.

#### **b. Lidhur me shpenzimet e llogaritura**

- 38.7 Konstatohet se analiza financiare e Kolegjit është mbështetur në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit mbi shpenzimet e mobilimit, shpenzimet jetike sipas INSTAT si dhe shpenzimet e udhëtimit për periudhën 2004-2016 sipas sistemit TIMS.
- 38.8 Për shpenzimet e mobilimit, në analizën e paraqitur prej tij, subjekti pretendon se pjesa më e madhe e mobilimit të apartamentit, në shumën 1.000.000 lekë është kryer në vitin 2002. Ky pretendim nuk përputhet me deklarin e tij vjetor të vitit 2004 (për vitin 2003) kur deklaroi si adresë banimi shtëpinë e prindërve (fakt i pohuar nga subjekti dhe në pyetësorin e Komisionit datë \*\*\* .07.2018, i pyetur mbi saktësinë e adresave të deklaruara të banimit).
- 38.9 Gjithashtu rezulton se shpenzimi për mobilim, deklaruar i kryer në vitin 2002, zë rreth 66% të totalit të ardhurave të subjektit të rivlerësimit deri në këtë periudhë (duke marrë në konsideratë këtu dhe depozitën e çelur në Bankën \*\*\* në dt. \*\*\* .08.2000, në shumën 5.191 euro).

<sup>9</sup> Në përputhje me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Diferenca prej 24% nga të ardhurat nga pagat nuk mjafton për të mbuluar shpenzimet minimale jetike për subjektin për këtë periudhë.

- 38.10 Lidhur me shpenzimet e udhëtimit, Kolegji ka përlllogaritur shpenzimet bazuar në të dhënat e sistemit TIMS për periudhën 2004-2016 sipas metodologjisë përkatëse. Subjekti në prapësimet e tij ndaj relacionit përmbledhës të analizës ekonomiko financiare të kryer nga Kolegji, ka paraqitur dokumenta dhe ka kërkuar marrjen e tyre në cilësinë e provës nga ana e Kolegjit, me qëllim justifikimin e shpenzimeve për një pjesë të udhëtimeve të kryera gjatë periudhës 2004-2016, pjesërisht të mbuluara nga institucionet pranë të cilit kanë qënë të punësuar subjekti dhe bashkëjetuesja e tij, si dhe akte/deklarata noteriale të të afërmeve të tyre, të cilët kanë deklaruar se për data të caktuara gjatë periudhës 2004-2016, subjekti dhe familjarët e tij janë akomoduar pranë tyre.
- 38.11 **Komisioneri Publik**, në seancën e datës 17.04.2019, paraqiti qëndrimin e tij lidhur me provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit me qëllim justifikimin e shpenzimeve, ku parashtroam se në referencë të formës dhe përmbajtjes së akteve një pjesë e tyre janë hartuar përtej kompetencave të funksionarit publik përkatës dhe për shkak të përmbajtjes së tyre, nuk janë marrë në formën që ligji parashikon.
- 38.12 Përsa i përket **formës**, deklaratat noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*\* .02.2019; nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*\* 02.2019; nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*\* .02.2019, të treja të hartuara nga noteri \*\*\*\*, janë marrë në \*\*\*\* dhe Genova Itali.
- 38.13 Në vlerësim të këtyre akteve, Komisioneri Publik iu referua ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për noterinë", i ndryshuar, që ka qënë në fuqi ditën e hartimit të akteve, i cili nuk parashikonte kompetencën e noterit publik shqiptar për ushtrimin e funksionit publik të tij jashtë kufijve të Shqipërisë.
- 38.14 Përsa i përket **përmbajtjes**, për gjithë aktet e paraqitura nga subjekti, deklaratat noteriale të sipërcituara si dhe deklarata noteriale e datës \*\*\* .02.2019 hartuar nga noteri publik \*\*\*\* dhe deklarata e datës \*\*\* .03.2019 e drejtuesve të shoqërisë " \*\*\* " dhe " \*\*\* ", Komisioneri Publik vlerësoi se këto janë akte që përmbajnë deklarime të shtetasve në cilësinë e personave private, e si të tilla ato duhet të trajtohen dhe verifikohen në kuadrin e respektimit të procedurave për marrjen e thënieve të dëshmitarëve gjatë një procesi gjyqësor.
- 38.15 Në rastet e sipërpërmendura, duke qënë se kemi të bëjmë me deklarime të tilla që duhet të konsiderohen si thënie dëshmitarësh, të cilat mund të konsiderohen me vlerë provuese vetëm në qoftë se janë marrë para nëpërmjet procedurës së caktuar, përfshirë njohjen e subjektit që jep thëniet me përgjegjësinë ligjore dhe betimin përkatës për të thënë të vërtetën dhe vetëm të vërtetën, kryer para organit përkatës shqiptar. Administrimi i këtyre deklaratave nga ana e Kolegjit sipas nenit 49/1/c të ligjit nr. 84/2016 nuk u jep atyre fuqinë provuese të deklarimeve të dëshmitarëve.
- 38.16 Në vështrim të sa më sipër, analiza financiare e kryer nga Komisioneri Publik, mbi kostot e udhëtimeve të subjektit të rivlerësimit dhe familjarët e tij është mbështetur vetëm në dokumentacioni e paraqitur nga subjekti, lëshuar nga institucionet pranë të cilëve subjekti dhe bashkëjetuesja e tij kanë qënë të punësuar, të cilët kanë konfirmuar kryerjen e udhëtimeve për arsye pune dhe mbulimin e kostove nga ana e tyre. Respektivisht shkresat nga KQZ, institucion pranë të cilit ka qënë e punësuar bashkëjetuesja e subjektit, mbulimi i shpenzimeve nga KLD sipas akteve të vëna në dispozicion me shkresën nr. \*\*\* datë \*\*\* .03.2019, mbulimi i shpenzimeve nga \*\*\* (vizitë në Luxemburg), si dhe mbulimi i shpenzimeve për udhëtimin në USA pranë të afërmeve, sipas deklaramit të subjektit edhe në DV 2014, në shumën 3.000 USD.



- 38.17 Nga analiza e këtyre akteve të paraqitura nga subjekti në prapësim të analizës financiare të Kolegjit, rezulton se kostot e udhëtimeve, nga 46.832,5 euro dhe 6.300 USD të përlllogaritura nga Kolegji, në një analizë financiare përfundimtare, në vlerën 45.302, euro dhe 3.300 USD.
- 38.18 Në konkluzion të sa më sipër, referuar edhe qëndrimin mbi të ardhurat e ligjshme dhe shpenzimet, nga analiza e financiare Komisionerit Publik i rezulton se subjekti i rivlerësimit **nuk** mbulon me të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, kursimin total në *cash* të deklaruar prej 10.493.870 lekë, për një diferencë negative prej – **6.712.886** lekë.
39. Në këtë aspekt të analizës financiare, deklarimet e subjektit në Kolegji, lidhur me deklarimin e kursimeve në deklaratat e interesave periodike privatë janë kontradiktore.
- 39.1 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij ndaj ankimit të Komisionerit Publik, në seancën e dates 11.12.2018 ka deklaruar se “... ka një shpërqëndrim lidhur me deklarimin e kursimeve familjare në *Cash*, si pasojë e deklarimit tim ndër vite. Në deklaratat periodike është deklaruar gjithmonë dhe vetëm pjesa që kursehej në të holla në dorë dhe nuk deklarohej se sa ishte gjendja nga viti paraardhës. Kjo ka qënë mënyra e deklarimit në ato vite dhe e tillë është konsideruar e rregullt nga organet kontrolluese për ato raste kur kemi pasur të bëjmë”.
- 39.2 Ndërkohë, në prapësimet e tij ndaj analizës financiare të përgatitur nga Kolegji, në seancën e datës 05.03.2019, lidhur me deklarimin e kursimeve në *Cash*, subjekti deklaroi se: “... dua të theksoj se një situatë e tillë në deklarimet e mia periodike është konstatuar dhe jashtë, përveçse dhe përpara procesit të rivlerësimit, pikërisht nga organi përgjegjës për kontrollin e pasurive ILDKPKI. Kështu më datë \*\*\*.04.2016 unë jam thirrur dhe jam pyetur pikërisht për këtë moment nga inspektori përgjegjës ku kam dhënë shpjegimet e mia, pikërisht sikundër dhe më lart parashtrova”.
- 39.3 Këtë deklarim të tij subjekti e ka shoqëruar edhe me një procesverbal të mbajtur në ILDKPKI në datë \*\*\*.04.2016, sipas së cilit rezultoi se subjekti është pyetur dhe ka parashtruar qëndrimin e tij në lidhje me kursimet në *Cash* të deklaruara.
- 39.4 Theksojmë se ky procesverbal është dokument që për herë të parë është paraqitur nga subjekti në këtë seancë dhe nuk rezultoi të jetë në inventarin e dosjes së subjektit të përgatitur nga ILDKPKI-ja, datë \*\*\*.11.2017<sup>10</sup>.
40. Në vlerësim të Komisionerit Publik, bazuar në ligjin nr. 9049/2003, i ndryshuar, subjektet deklaruese duhet të deklarojnë çdo pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, të drejtat reale mbi to si dhe të paraqesin saktë shtesat dhe pakësimet e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, ku përfshihen dhe likuiditetet në bankë dhe në banesë, duke deklaruar njëkohësisht dhe burimin e krijimit të tyre. Gjithashtu neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se deklaratat periodike vjetore të paraqitura më parë në ILDKPKI mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji.
41. Ky arsytim pasqyrohet dhe në jurisprudencën e Kolegjit, ku në vendimin nr. 5 datë 18.02.2019, shprehet se: “*Deklarata e re e plotësuar për efekt të procesit të rivlerësimit për secilin prej kritereve, shërben si pikënisje e këtij procesi dhe deklarimet e subjektit ballafaqohen me të dhënat e mbledhura nga organet e rivlerësimit, sipas përcaktimeve të neneve 45-52 të ligjit nr. 84/2016*<sup>11</sup>.”

<sup>10</sup> Në këtë procesverbal të mbajtur nga ILDKPKI-ja, paraqitur nga subjekti, rezultoi se janë administruar gjithashtu si dokumentacion justifikues edhe kontratat e shitblerjes së automjeteve, “Mercedes Benz” (shitje dhe blerje) në emër të SR, “Opel Corsa” (shitje dhe blerje) në emër të BSH, si dhe automjetit “Land Rover” në emër të SR.

<sup>11</sup> Shiko prg nr.22 të vendimit nr.5 datë 18.02.2019 për SR.\*\*\*



42. Nga sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit për të gjithë periudhën e deklarimit për vitet 2004-2016 ka kryer deklarim të pasaktë, referuar nenit 33, germa "a" të ligjit nr. 84/2016. Nga analiza financiare, sa arsyetuar më sipër, rezulton se subjekti nuk mbulon me burime të ligjshme kursimet e deklaruara 10.493.870 lekë për një diferencë negative prej – **6.712.886 lekë**.
43. Për Komisionerin Publik, nga shqyrtimi gjyqësor u provua se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm në lidhje me burimin e krijimit të pasurive në pronësi të personit të lidhur, bashkëjetueses së tij, si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e likuiditeteve, sipas nenit D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronjat "a" dhe "b" të ligjit nr. 84/2016.
44. Bazuar në këto konkluzione, Komisioneri Publik çmon se subjekti i rivlerësimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, ka kryer deklarim të pamjaftueshëm në kuptim të pikave 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronjat "a" dhe "b" të ligjit nr. 84/2016, duke bërë kështu deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, në kuptim të nenit 61, pika 3, 5 e ligjit nr. 84/2016.
45. Si përfundim, mbështetur në parashikimin e nenit F, pika 3 dhe 7 e aneksit të Kushtetutës, nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, kërkojmë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të vendosë:
- Ndryshimin e vendimit nr. 22, datë 07.06.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit z. Edmond Islamaj.

**KOMISIONERI PUBLIK**

  
**Florian BALLHYSA**